




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr Prot. Br. Prot. <u>01-884/14</u>
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages <u>02</u>	Data Datum Date <u>14.03.2014</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 pika 11,12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.03.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-4234/13, për z. Sami Hasani – Kryesues i Departamentit të Financave dhe Tarifave Rregullatore në Zyren e Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Sami Hasani – Kryesues i Departamentit të Financave dhe Tarifave Rregullatore në Zyren e Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat N.T.P. “Labela”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z. Hasani është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit. Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Me këtë rast ai është bindur me fakte për situatën në të cilën ndodhet si dhe ndryshimet të cilat duhet ti bëj për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Hasani, në këtë takim ka deklaruar se brenda afatit ligjor do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar në biznes privat dhe do të vazhdoj të ushtroj funksionin e tij publik.

Zyrtari i lartë z. Hasani ka dërguar në Agjenci shkresen zyrtare të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI-03-846/14) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka hequr dorë nga pozita e personit të autorizuar që e ushtronte në N.T.P. "Labela".

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së ;
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës).

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

